



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:168031

Datë: 25.09.2024

Numri i dokumentit: 06210035

**PA1.nr.1296/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri kryetari i kolegjit, Violeta Husaj Rugova dhe Skender Çoçaj anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantes Gjyqësore në cilësi të procesmbajtëses Fitore Zeka, në çështjen penale kundër të pandehurit E. G. për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit av. Q. R., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti i përgjithshëm P.nr.776/24 të dt. 10.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me 11.09.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit E. G., e av. Q. R., ndërsa aktgjykimi Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti i përgjithshëm P.nr.776/24 të dt. 10.05.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm P.nr.776/24 të dt. 10.05.2024 i akuzuari E. G. është shpallë fajtorë për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KRK-së dhe është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 1800 € (njëmijë e tetëqind euro) i cili dënim do të ekzekutohet brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pasi aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm. Nëse i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do t'i caktohet një ditë burgim. Në bazë të nenit 366 paragrafi 3 i KPRK-së nga i akuzuari konfiskohet revolva e tipit Zastava C635, kalibër 8mm, me numër serik T6102775, e cilat duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunim me institucionet tjera relevante, sipas procedurave standarde në fuqi dhe është obliguar i akuzuari i lartcekur që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20€ (njëzet euro) dhe shumën prej 20€

(njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi të cekur si më lartë, në afat ligjorë ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit, av. Q. R., me dt.18.06.2024, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e atakuar P.nr.776/24 të dt.10.05.2024 ta ndryshoj ashtu që të pandehurit ti shqiptoj një dënim më të butë.

Prokurori i Apelit në Prishtinë, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1294/2024, datë 14.08.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e apelit pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës, analizoi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPRK-së dhe pasi vlerësoj pretendimet e cekuar në ankesë gjeti se :

#### **Ankesa nuk është e bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i ankimuar nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 par.1 të KPPRK-së dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPP-së, apo shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kishin kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu, me ankesën e mbrojtëses nuk kontestohet as gjendja faktike në këtë çështje penale prandaj, as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, e që në fakt as që ka mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore konform nenit 383 par.2 të KPP-së, ngase i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij ka pranuar fajësinë për këtë veprë penale për të cilën gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, andaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore të paraqitura nga mbrojtësi i të akuzuarit përkitazi me vendimin për sanksion penal.

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit për një dënim më të butë, nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform nenit 69 dhe 70 të Kodit Penal, i cili ishte në fuqi gjatë kohës së kryerjes së veprës penale, ashtu që si rrethana lehtësuese pati parasysh pranimin e fajësisë nga i akuzuari në faza të hershme të procedurës, shprehjen e pendimit për veprën të cilën e ka kryer, premtimin se nuk do të përsëris veprime të tilla, ndërsa si rrethana rënduese mori faktin se i njëjti edhe me herët është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë dhe atë aktgjykimin P.nr.657/20211.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka

vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet si në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit për shqiptimin e një dënimi më të butë nga se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate nuk qëndrojnë ndërsa rrethanat e tjera të cekura në ankesë nuk janë të asaj natyre të cilat kishin për të justifikuar dhe ndikuar për një vendim dhe lartësi tjetër nga ai i shqiptuar si në aktgjykimin e ankimuar.

Pretendimi ankimor se vepra nuk hynë në kategorinë e veprave të rënda dhe se i akuzuari nuk e kishte përdorur armën. Kjo gjykatë sjellën në vëmendje se të akuzuarit nuk i vihet në barrë përdorimi i armës dhe kjo nga gjykata e shkallës së parë as nuk është venë në dyshim. Ndërsa sa i përket faktit se kjo vepër penale a është e natyrës së rëndë, ligjvënësi këtë vepër penale ka përcaktuar me dispozitën e nenit 366 par. 1 të KPRK-së dhe ka paraparë dënimin me gjobë me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet. Çka do të thotë se dënimi i shqiptuar me gjobë është në suaza ligjore dhe krahas vlerësimit të rrethanave të cekura si më lartë për dënimin nga gjykata e shkallës së parë. Nga të dhënat personale të konfirmuara në shqyrtim fillestarë rezulton se i akuzuari ishte i moshës 20 vjeçare në kohën e kryerës së veprës penale, ndërsa në kohën e gjyqimit i moshës 24 vjeçare dhe mbrojtja nuk ka thënë ndonjë arsye relevante për ndikimin e dënimit në ekonomin familjare të akuzuarit. Prandaj edhe pretendimet sa i përket moshës së re dhe ndikimi në ekonomin familjare nuk qëndrojnë. Nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë rezulton se me rasatin e vendosjes për dënimin gjykata kishte patur parasysh edhe qëllimin e dënimit të parapara për veprën penale, qëllim ky i përcaktuar me nenin 38 të KPRK-së.

Andaj, si përfundim edhe kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit me aktgjykimin e ankimuar, është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe me intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe me të do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë sipas nenit 38 të KPRK-së, siç është parandalimi i të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 401 të KPRK-së.

**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2020:168031, 11.09.2024**

Procesmbajtësi,

Fitore Zeka

Anëtarët e Kolegjit,

Violeta Husaj Rugova

Skender Çoçaj

Kryetari i Kolegjit,

Zyhdi Haziri